



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME Durrës SH.A.
DREJTORIA TEKNIKE

Nr. _____ prot.

Durrës, më ____/____.2018

Lënda: Hartim i specifikimeve teknike dhe kriterëve kualifikuese të operatorëve ekonomik për objektin: **“Rrethim i ambjentit të jashtëm Depo Uji nr.2, nr.2/1, Lagja nr.7 dhe Depo Uji nr.4 Arapaj, Durrës”**.

ZNJ.Floriana KAPO
DREJTORE JURIDIKE

Për Dijeni : Z.Spartak KOVAÇI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Z.Denis GJONI
DREJTORI TREGTAR

Referuar urdhërit për fillimin e procedurës Nr.2506/1Prot. Datë 23.08.2018, me objekt : **“Rrethim i ambjentit të jashtëm Depo Uji nr.2, nr.2/1, Lagja nr.7 dhe Depo Uji nr.4 Arapaj, Durrës”** ,
Dega Teknike rendit specifikimeve teknike dhe kriterëve kualifikuese të operatorëve ekonomik si më poshtë:

- 1. Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të ketë kryer a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.**

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

“Ujesjelles Kanalizime”sha Durrës
Adresa:L.17.Rr.Dalip Peza

Tel/Fax 052238329.

1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudit;
5. Çertifikatën e marrjes në dorezim.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh duhet të paraqitet si vijon:

- Kontrata e Bashkim Operatorësh deklaruar në fazën e tenderimit
- Prokura e posaçme e Bashkim Operatorësh deklaruar në fazën e tenderimit

Në rast se kontrata e paraqitur është realizuar si Nenkontraktor duhet të paraqitet si vijon :

- Kontrata baze ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor
- Miratimi zyrtar si nenkontraktor zyrtar nga ana e autoritetit kontraktor

Nuk do të merret parasysh asnjë punim i pavërtetuar.

- b) Për kontratat e realizuara me subjekte private, përveç dokumentave të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat tatimore të shitjes (ku shprehen qartë data, shumat, sasinë, emërtimet dhe vlerat)

Nëse objekti i ngjashëm i paraqitur është ndërtuar me financim të vetë ofertuesit, ai duhet të paraqesë lejen e ndërtimit, situacionin përfundimtar, lejen e shfrytëzimit dhe faturat tatimore përkatëse.

Kontrata të ngjashme konsiderohen të vlefshme nëse zerat kryesorë të punimeve kanë vlerë të konsiderueshme krahasimë me ato të përcaktuara për këtë prokurim.

- 2. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Shqyrtimi i licensave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara në sa më sipër. Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme sipas modelit nga Ministria e Infrastruktës dhe Energjisë:**

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licencat e mëposhtme:

- | | |
|---------|--|
| NP-1A | Punime gërmimi në tokë |
| NP-7A | Ujësjellës, gazësjellës, vajësjellës, vepra kullimi e vaditje. |
| NS-1 A | Punime në prishjen e ndertimeve. |
| NS-7 A | Punime barrier dhe mbrojtje rrugore. |
| NS-8 A | Punime ndërtimi parafrabikate beton arme, struktura metalike dhe druri |
| NS-18 A | Punime topogjeodezike |

- 3. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat ISO:**

- Çertifikatë: Sistemi manaxhimit të cilësisë (ISO 9001- 2015 e vlefshme)
- Çertifikatë: Sistemi manaxhimit të mjedisit (ISO 14001-2015 e vlefshme)

- Çertifikat: Sistemi manaxhimit te integruar (BS PAS99-2012 e vlefshme)
- Çertifikat: Sistemi manaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune (OHSAS-18001-2007 e vlefshme)
- Çertifikatat: Sistemet Manaxhimit te cilesise ne saldim (ISO3834-2:2006 e vlefshme)

Lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Çertifikatat kërkohet të janë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Çertifikatat të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

- 4. Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton që për periudhën Nëntori 2017- Nëntori 2018 ,ka pasur të punësuar për këtë periudhë mesatarisht jo më pak se 15 punonjës (duke përfshire edhe stafin tekniko menaxherial). Punëtorët të jenë të deklaruar me kohë të plotë.**

Për këtë, dokumentacioni që duhet të paraqesë është:

- a. Vertetim nga sig shoqerore apo dega tatimeve per numrin e te punesuarve dhe qe u jane paguar detyrimet për kontributet e tyre për muaj e periudhës së mësipërme ,
- b. Liste pagesat e konfirmuar nga administrata tatimore për muajt e kësaj periudhe.

4.1 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik në stafin e tyre si më poshtë:

Inxhinier Ndërtimi 1 punonjës
Inxhinier Mekanik 1 punonjës
Inxhinier Hidroteknik 1 punonjës

Për plotësimin e kushtit të mësipërm kërkohet:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës personelin si më sipër duhet ta kenë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, Libreze dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

4.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjes të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, nga të cilët:

- Specialist ndertimi 2(dy)
- Specialist per kontruksione metalike 2 (dy)
- Karpentier 3 (tre)

Gjithashtu Operatori Ekonomik duhet te kete ne stafin e tij te pakten **1(nje) Teknike Ndertimi.**

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarinë e mësipërm.

4.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë një person që përmbush kriteret për të qenë koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, i cili duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas

kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Per specialistin e kërkuar si më sipër, duhet të paraqitet:

- Çertifikata e trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë e dhënë nga një organizëm i licencuar/certifikuar, shqiptar ose i huaj dhe kontrata e punës.

5. Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

- Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamiona, kapaciteti total mbajtës minimumi mbi 18 T	në pronesi ose me qera	copë	1
2	Kamion vetëshkarkues 7.5 ton - 18 ton	në pronesi ose me qera	copë	1
3	Motogjeneratorë	në pronesi ose me qera	copë	1
4	Motosaldatrice	në pronesi ose me qera	copë	1
5	Fadromë me goma	në pronesi ose me qera	copë	1
6	Kamionçine	në pronesi ose me qera	copë	2
8	Autobot	në pronesi ose me qera	copë	1
10	Autobetoniere	në pronesi ose me qera	copë	1
11	Vibrator	në pronesi ose me qera	copë	2
12	Pompë uji	në pronesi ose me qera	copë	1
13	Kamion me vinç	në pronesi ose me qera	copë	2
14	Eskavator me zinxhir	në pronesi ose me qera	copë	2
16	Matrapik	në pronesi ose me qera	copë	1
18	Betonforma	në pronesi ose me qera	m2	100
19	Mini fadrome me kove para	në pronesi ose me qera	copë	1

- Kokore +Jeleke fosforoshente minimumi 20 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 10 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcs Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë

ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).

Autoriteti Kontraktor ka të drejtën të kryejë të gjitha verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësiperm.

- 6. Afati i përfundimit të punimeve të jetë 30 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës.**

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t'i përmbahen VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik " si dhe te respektojnë rigorozisht udhëzimet e APP per operatorët ekonomike per rastin e bashkimit te operatorëve ne procedurat elektronike te prokurimit . Mos respektimi i udhëzimeve te APP sjell skualifikim te operatorit.)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Bashkangjitur Projekt-Zbatimi i hartuar nga Dega Teknike me vlerë 10,507,998 lekë pa t.v.sh.

Grupi i hartimit të specifikimeve.

Ing. Lorenc Facja

Ing. Marsida Balla